



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 46/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2020, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a*”, me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistics” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Cerciz Topulli”, nr.17, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: OSHEE sh.a
Adresa: Blv. "Gj.Fishta", Nd.88, H.1, 1023, Tiranë.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren: **I**

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ankimuesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Ankimuesit kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të ankimuesve.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.08.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, "*Procedurë e hapur*", me objekt "*Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a*", me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

II.2. Në datën 18.11.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.11.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Kristalina - KH” sh.p.k.	112,121,880.00 lekë, Skualifikuar;
2. “Infosoft Office” sh.p.k	118,710,003.62 lekë, Skualifikuar;
3. “Interlogistics” sh.p.k.	122,361,614.00 lekë, Kualifikuar;
4. “Albdesign PSP” sh.p.k	124,987,220.00 lekë, Skualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“OE Kristalina KH nuk ploteson kriterin e pervojave (furnizimeve) te meparshme, te ngjashme per zerat kancelari.

OE Kristalina KH nuk paraqet Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise dhe Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne perputhje me objektin e prokurimit. Certificate ISO kane per objekt vetem shtypshkrimet dhe jo kancelarite ”

II.4.1. Në datën 03.12.2019, operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistics” sh.p.k.

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 24192/3 Prot. datë 11.12.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.4.3.Në datën 18.12.2019, operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Lidhur me arsyen pare te skualifikimit, sqarojme se nga ana e Autoritetit Kontraktor ne pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik eshte percaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.1Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 50,000,000 (Pesdhjete milion) leke.

Ne rast se kontrata eshte kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ne rast se kontrata eshte kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm ne kemi paraqitur kontrata dhe vërtetime për realizim të sukseshëm të tyre me disa Institucione Publike, po ashtu kemi paraqitur dhe fatura tatimore TVSH ku provohet shitja e artikujve të njëjtë me listën e mallrave objekt prokurimi të realizuar si me

sektorin privat ashtu dhe me sektorin publik. Vlera ne total e të gjitha kontratave dhe furnizimeve sipas faturave tatimore të shitjes së artikujve të ngjashmëm dhe të njëjtë me mallrat objekt prokurimi është rreth 120.000.000 (një qind e njëzet milion) lekë, pothuajse sa vlera e fondit limit që prokurohet. Nëse do ti referohemi vleres zë për zë, për të cilën ne kemi dhënë ofertën tonë, rezulton se: Nga oferta totale prej 112.121.800 leke pa tvsh, rreth 108.296.200 leke pa tvsh janë shtypshkrime të mirefillta dhe artikuj kancelarik të cilët realizohen nëpërmjet shtypshkrimit. Ndërsa diferenca e mbetur nga vlera totale janë artikuj kancelarik, artikuj importi të cilët gjenden lehtësisht në tregun e lirë, si p.sh: Shufra lidhëse, Spirale Lidhëse, CD, DVD, Kapse Aktesh, USB, Tela, Ndarës, Laps, Stilolaps, Portamin, Shënjues, Korrektor, Skoç, Vizore, Gershere, Prese Lapsi, Gome, Makine Llogaritëse, Gome per laps, Pastrues Monitori. Vlera e ofertes e cila i korespondon artikujve të mirefillte kancelarik të cilët janë mallra importi dhe gjenden lehtësisht në treg nuk zë as 5 % të totalit të ofertës së ofruar nga ana jonë. Gjithashtu duam të bëjmë me dije autoritetin kontraktor se përderisa kontrata nuk është ndarë në lotë me qëllim për të përcaktuar fondin limit të artikujve kancelarik të mirëfilltë dhe të produkteve të shtypshkrimit si dhe artikujve kancelarik që realizohen ndëpërmjet shtypshkrimit, me qëllim që nga ana e KVO të mos krijohej konfuzion në fazën e vlerësimit të ofertave dhe për më tepër mos të abuzohej gjatë vlerësimit duke gjykuar apriori se “x” subjekt nuk e ka paraqitur kontratën apo kontratat e ngjashme siç duam ne ! Por cilat referenca në vlera për njërin dhe për tjetrin grup artikujsh i referohet KVO në rastin tonë meqë pretendon se ne nuk kemi kontratë të ngjashme për artikuj kancelarik ?!

Tani në këtë fazë dhe në këto kushte me të cilat është zhvilluar kjo procedure është e pamundur për KVO për të dalë në një konkluzion final dhe për të thënë se është plotësuar apo jo kontrata e ngjashme nga ana jonë.

Gjithësesi, duke presupozuar se KVO gjatë vlerësimit të ofertave ka konkluduar mbi bazën e shumës numerike të artikujve kancelarik dhe jo mbi bazën e vlerës me të cilën kemi ofertuar ne, atëherë, duam tju bëjmë me dije se ne kemi paraqitur furnizime të ngjashme për artikuj kancelarik në një masë që e tejkalon 40% e vlerës së ofertuar nga ana jonë për artikuj kancelarik të importit.

Në pikën 4 të nenit 27 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “RPP” të ndryshuar është përcaktuar se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga interpretimi literal i kesaj dispozite nën ligjore, vlen të përmendet fakti se në rastin tonë kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi dhe me një fond limit në dispozicion, në këtë kuadër mjafton se operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë realizuar furnizime të ngjashme të mëparshme, dhe kurësesi të kenë realizuar furnizime të mëparshme të njëjta dhe zë për zë referuar listës së mallrave objekt kontrate. Ne operatorë ekonomikë të interesuar dhe me qëllim që të mos lindin këto konfuzione për KVO, madje do thoja keq interpretime dhe një keq dashje për të paracaktuar fituesin e një tenderi, lidhur me këtë procedurë prokurimi i jemi drejtuar Autoritetit tuaj Kontraktor me ankesë duke kërkuar ndarjen në lotë të kësaj kontrate. Ankesa nuk është pranuar nga ana juaj dhe ne i jemi drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt ankese.

Në datën 16.10.2019 Komisioni i Prokurimit Publik u shpreh me vendimin KPP 664/2019, në pikën III.1 “Arsyeton”, KPP ka arsyetuar se : III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues për ndarjen në lote të procedurës së prokurimit me argumentin se: “Se pari: kerkojme

ndarjen ne lote te kesaj procedure shtypshkrimet me vete dhe kancelarite me vete, sepse Autoriteti i ka publikuar si njeprocedureprokurimi per te dyja produktet. Objekti i procedures eshte "Blerje kancelari dheshtypshkrime per nevojat e shoqerise OSHEE sha" dhe eshte percaktuar procedure e hapur per mallra pra objekti kryesor eshte blerja e mallrave dmth e kancelarive. Ne ligjin e prokurimit publik neni 1 pika 2 percakton: "Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;" Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "5.Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor". Ne ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 46, pika 3 përcaktohet: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen, në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik."

Ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit)pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesmarrjes së operatorëve ekonomike në nje procedure prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një ëpunë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Ne mendojme dhe gjykojme se artikujt e kancelarive si skoc, usb, korrektor stilolaps, marker permanent, maja portamine, portamin, laps, stilolaps, tela makiner 24/6, makine qepese, kapëse aktesh, ndares dokumentash, shënjes per firmosje, skoc transparent, ngjites stick, dosje kartoni me llastik, dosje kartoni me buton, dosje arkive më mekanizem, bllok shënimesh etj (e gjithë lista e kancelarive) duke qene se jane mallra kancelari ato nuk hyjne ne grupin e shtypshkrimeve te cilat do te prokuroje autoriteti kontraktor. Kancelarite mund të prokurohen në një lot më vetë në mënyrë që të zgjerohet rrethi i pjesmarrësve në procedurën e prokurimit. Mendojmë se në rastin konkret, mosndarja në Lote nga autoriteti kontraktor e procedurës së prokurimit zvogëlon numrin e shoqërive që do të shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar të tyre."

Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: III.1.1. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2 prashikohet shprehimisht se:

"Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;"

III.1.2. Në nenin 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlerae kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në

gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimit, KPP konstaton se objekti i këtij prokurimi është blerja e artikujve kancelarik të cilat, për të përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor duhet të realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, si dhe blerjen e artikujve të ndryshëm dhe standartë, kancelarik.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit, një lot artikujt standart kancelarik dhe një lot artikujt kancelarik të cilat realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb të gjithë artikujt objekt prokurimi i përkasin të njëjtës kategorie produktesh. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipër përmendur .

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Duke iu referuar me sipër dhe vendimit të KPP, i cili në pikën III.1.3 të pjesës arsyetuese ka konkluduar dhe konstatuar se “.....objekti i këtij prokurimi është blerja e artikujve kancelarik të cilat, për të përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor duhet të realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, si dhe blerjen e artikujve të ndryshëm dhe standartë kancelarik”. Pra qartësisht kemi të bëjmë me një objekt të vetëm prokurimi ku pjesa dërmuese e artikujve që prokurohen janë shtypshkrime dhe artikuj kancelarik që realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, ndërsa një pjesë e vogël janë zëra të artikujve të ndryshëm dhe standartë kancelarikë. Sa më sipër gjykojmë se skualifikimi i ofertës tonë duke përdorur këtë arsye nuk qëndron.

Lidhur me arsyen e skualifikimit, sqarojmë se nga ana e Autoritetit Kontraktor në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik janë përcaktuar kriteret si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Certifikate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësive, të vlefshme e leshuar nga një organ i akredituar.

Certifikate ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, të vlefshme e leshuar nga një organ i akredituar. Në rastin e bashkimit të operatoreve, secili anëtar duhet të paraqesë ISO në përputhje me zërat që do të marrë persiper të furnizojë.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm, ne kemi dorëzuar dokumentat e mëposhëm:

A. ISO 9001:2015, leshuar nga kompania “CERTI Ë”, e vlefshme deri në datën 03.05.2022, me veprimtari:

“Sigurimi i veprimtarisë të tipografisë dhe të printimit të materialeve të reklamimit, botimit si dhe materialeve të tjera”

B. ISO 14001:2015, leshuar nga kompania “CERTI Ë”, e vlefshme deri në datën 03.05.2022, me veprimtari:

“Sigurimi i veprimtarisë të tipografisë dhe të printimit të materialeve të reklamimit, botimit si dhe materialeve të tjera” Lidhur me arsyen e skualifikimit se “...Kristalina KH nuk paraqet Çertifikate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësive dhe Çertifikate ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor në përputhje me objektin e prokurimit. Çertifikimet ISO kanë për objekt vetëm shtypshkrimet dhe jo kancelaritë”, sqarojmë si më poshtë: Së pari arsyeja e përdorur nga KVO vjen

ndesh me nenin 55/2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “LPP” të ndryshuar, sipas të cilit nuk duhet të përdoret nga autoriteti kontraktor, për skualifikimin e një operatori, asnjë kriter i cili nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit ! E themi këtë pasi në kriterin e pikës 2.3.2 të Kapacitetit Teknik të DST nuk është përcaktuar se çertifikata ISO 9001 dhe 14001 duhet të përfshijë artikujt “kancelarike” Sigurisht që kërkesa për paraqitjen e certifikatave ISO edhe pa përcaktuar fushën e veprimtarisë nënkupton që bëhet fjalë dhe se duhet të përfshijë objektin e prokurimit, ne do të ndalemi në 3 momente : 1.Momenti i parë ka të bëjë me interpretimin që KPP ka bërë në pikën III.1.3 të Vendimit KPP 664/2019, datë 16.10.2019: “III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimit, KPP konstaton se objekti i këtij prokurimi është blerja e artikujve kancelarik të cilat, për të përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor duhet të realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, si dhe blerjen e artikujve të ndryshëm dhe standartë,kancelarik” Referuar këtij konstatimi i KPP-së, rezulton se veprimtaria që përfshin Çertifikata ISO 9001 dhe 14001 është në përputhje të plotë me kërkesat e kualifikimit si dhe në përputhje të plotë lidhur me atë çka kërkohet të arrihet me realizimin e kësaj kontrate.

2.Momenti i dytë ka lidhje me shpjegimin në pikën e parë më sipër si dhe me objektin e veprimtarisë që kanë të përcaktuara të dyja çertifikatat ISO 9001 dhe 14001 “Sigurimi i veprimtarisë të tipografisë dhe të printimit të materialeve të reklamimit, botimit si dhe materialeve të tjera” Pra lëshuesi i këtyre ISO ka çertifikuar kompaninë tonë më të gjitha veprimtritë që përfshihen dhe që parashikohen në objektin e kontratës që prokurohet.

3.Momenti i tretë ka të bëjë me arsyen që nxjer në këtë fazë KVO “mungon çertifikimi për kancelari” ?! A mund të na thotë KVO se cila është ajo kompani shqiptare e cila është çertifikuar me ISO 9001 dhe 14001 për prodhimin e makinave llogaritëse, stilolapsave, USB, Vizore etj ? Pra kjo kërkesë bie dhe ska mbështetje ligjore, AK mund të kërkontë që për këto pak artikuj kancelarik, operatorët ekonomik të paraqesnin çertifikatën ISO 9001 dhe 14001 të prodhuesit, por jo ISO për prodhim artikuj kancelarik për një kompani shqiptare. Nisur nga sa argumentuam me sipër gjykojmë se arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.

Duke qënë se për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë janë përdorur arsye si kontrata të ngjashme apo çertifikata ISO, atehërë kërkojmë nga komisioni i shqyrtimit të kësaj ankesë që në kuadër të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik lidhur me kërkesat e kualifikimit në ngarkim të tyre, duam që të verifikoni pretendimet tona të mëposhtme dhe të skualifikoni subjektin INTERLOGISTIC shpk, për arsyet si më poshtë:

1.Interlogistik shpk duhet të skualifikohet pasi nuk disponon kontrata të ngjashme në masën 40 % të fondit limit, sikurse e cituam dhe me lart, jemi të bindur se ky subjekt nuk ka realizuar asnjëherë gjatë aktivitetit të tij shërbime të ngjashme në fushën e shtypshkrimeve. Referuar edhe Listes Kombetare të profesioneve është lehtësisht e verifikueshme që shoqëria Interlogistic shpk nuk ka në stafin e vet të punësuar asnjë specialist shtypshkronje, por ka punonjes me profesione të pershtatshme për fushën e veprimtarisë së kësaj shoqërie pikerisht për shitje (tregeti) dhe shërbime. Sikurse e theksuam dhe me lart shtypshkrimet zënë peshën kryesore të kësaj kontrate dhe lidhur me këtë subjekti Interlogistic shpk nuk ka realizuar asnjëherë kontrata apo shërbime të ngjashme që përfshijnë fushën e shtypshkrimeve.

2.Subjekti Interlogistic shpk për të përmbushur kriterin e pikës 2.3.2 Certificate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësise, të vlefshme e leshuar nga një organ i akredituar, ka paraqitur një Certifikatë ISO 9001:2015 të lëshuar nga Sistemi i Akreditimit të Republikës Helene me nr 846-2 i cili akrediton ICDQ SHPK në Tiranë dhe nëse bëjmë një analizë me sy të lirë të objektit të akreditimit në lirisht vëmë re se në tabelën dhe të dhënat që pasqyrohen në të (kodi EA/IAF, Objekti i plotë ose i kufizuar, dhe Aktiviteti i akredituar) si dhe të cituar në faqen 2 të këtij dokumenti dhe me saktësi në pikën 9 (sipas kodit EA/IAF), shihet që për Printime dhe shërbime të lidhura me shtypjen objekti për këtë operator ekonomik është i limituar dhe në këtë pikë nuk përmendet askund

fjala e shkruar ne faqen e pare “Artikuj per zyra- kancelari- bojra printer Lidhur me kete argumentim ne mendojme se edhe kjo ISO eshte e falsifikuar dhe ky operator ekonomik nuk e disponon kete ISO cka do te thote qe nuk permbush kushtet per tu kualifikuar por eshte arsye e forte dhe qe nuk mund te anashkalohet , per tu skualifikuar dhe perjashtuar. Nga sa me siper kuptohet qe ky operator ekonomik nuk e mbulon te gjithë objektin e kodit perkates IAF.

Subjekti Interlogistic shpk për të përmbushur kriterin e pikës 2.3.2 “Certifikate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, te vlefshme e leshuar nga nje organ i akredituar”, ka paraqitur një Certifikatë ISO 14001:2015 të lëshuar nga ICDQ Spanjë me nr.384/14!

Kjo certifikatë është e falsifikuar për arsye se:

1.I mungon nëshkrimi i lëshuesit të saj, në certifikatë është vëndi i nënshkrimit të drejtorit të këtij instituti por mungon firma. Si duket falsifikuesi i saj nuk ka patur guximin të nënshkruaje në emër të dikujt tjetër .

2.Nga verifikimi në internet në faqen e kompanisë ICDQ Spanjë nuk rezulton asnjë certifikate me nr.384/14 e lëshuar në emër të interlogistic shpk.

3.Certifikata ISO lëshuar nga ICDQ Spanjë me nr.384/14, është përpiluar e gjitha në gjyhen shqipe, nuk ka asnjë shans që një kompani në Spanjë, Itali apo Francë të lëshojë një certifikatë ISO dhe të lëshojë në një gjyhe të ndryshme nga ajo e vendit që përfaqson.

4.Nëse i referohemi “Aneksit Teknik” (dokument i perkthyer, noterizuar dhe dorzuar ne tender) Akreditimi nr.17/C-MA026, Plani i Akreditimit per subjektin “ICDQ” me adrese Barcelonë Spanjë, me Titull: “Certifikimi i sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit sipas normes UNE-EN ISO 14001:2015 per sektoret dhe nensektoret e përcaktuar me poshtë”. Nuk përfshihet asnje veprimtari e cila përfshin objektin e prokurimit.

5.ICDQ Spanjë nuk është e akredituar për të lëshuar Certifikata ISO 14001:2015 që përfshin veprimtarinë e shtypshkrimeve.

Për një rast të ngjashëm është shprehur dhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin KPP 845/2018, datë 17.12.2018, në faqen 21 pika III.1.8 të pjesës arsyetuese, shprehet se:

“.....nga verifikimet e kryera sipas udhëzimeve në manualin teknik të

Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, rezulton se trupa certifikuese ICDQ është akredituar për auditime dhe certifikime për standartin OSHAS 18001:2007 për aktivitetet ekonomikesipaskodeve EA/IAF 17, 24, 28, 29, 30, 31, 35 dhe 39 nga organizmi akreditues ESYD(organizëm pale 22 në marrëveshjen e bashkëpunimit EA), si dhe është akredituar për auditimedhecertifikimepërstandartin UNE-EN ISO 14001 : 2015 për aktivitetet ekonomike sipas kodev eEA/IAF1,2,3,4,5,8, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37 dhe 39 nga organizmi akreditues ENAC (organizëm palë në marrëveshjet e bashkëpunimit EA, IAF dhe ILAC). Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k., nuk është i certifikuar për standartet e kërkuara lidhur me cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe menaxhimin mjedisor për aktivitetin ekonomik që do të kryej për zbatimin e kontratës object prokurimi (shërbime printimi). Nga ana tjetër, certifikatat OSHAS 18001 : 2007; UNE-EN ISO14001:2015, të paraqitura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k.janëlëshuarnga një trupë certifikuese e cila nuk është e akredituar për të audituar apo certifikuar në këto standarte për aktivitetin objekt proukrimi, aktivitet i cili, sipas EA/IAF ka kodin 9 “Kompani Printimi” ose kodin NACE 18, sipas dokumentit udhëzues të Organizmit EuropiantëAkreditimit, që bazohen në aneksin 1, të rishikimit 2, të “NACE- National ClassificationsofEconomicActivities” (Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve Ekonomike), miratuar në Rregulloren (EC) të Parlamentit European nr.1893/2006. Komisioni gjykon se, trupat certifikuese duhet të jenë të akredituara në mënyrë vecantë për secilin aktivitet ekonomik sipas klasifikimit kombëtar të miratuar nga Parlamenti European, pasi këto aktivitete janë totalisht të ndryshme nga njëra tjetradhekanësecila specifika dhe kërkesa të vecanta lidhur me plotësimin e standarteve, e për rrjedhojakreditimii një trupe certifikuese për auditim dhe

certifikim në një standart të caktuar, për një apo disa prej aktiviteteve ekonomike, nuk e bën këtë të fundit automatikisht të akredituar për të audituar dhe certifikuar kompani në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike. Në këto kushte, Komsioni gjykon se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k. ka paraqitur certifikata BS OHSAS 18001: 007 dhe UNE-EN ISO 14001:2015, jo për aktivitetin objekt prokurimi, sidhetëlëshuara nga nga një trupë certifikuese e cila nuk është e akredituar për certifikimin e kompanive që kryejnë shërbimet e printimit, e për rrjedhojë nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 9, pika 2.2.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën përkatëse, pasi këto certifikata nuk vërtetojnë nëse ky operator ekonomik plotëson standartet e kërkuara për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe menaxhimin mjedisor për aktivitetin ekonomik që do të kryej për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Fakti që një operator ekonomik është i certifikuar sipas standarteve ISO18001 dhe ISO 14001, për një apo disa prej aktiviteteve ekonomike, nuk e bën këtë të fundit automatikisht të certifikuar sipas standarteve të mësipërme në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike” Nisur nga rasti i mësipërm dhe i gjykuar nga KPP, jemi përpara të të njëjtit fakt nga ku provohet katërcipërisht se ICDQ Spanjë nuk është i akredituar për të lëshuar certifikata ISO 14001:2015 që përfshin fushën e shtypshkrimeve. Materiali bashkelidhur Certifikates ISO 14001:2015 nuk është perkthyer nga një perkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë për gjuhën spanjolle (Ashtu sic e kërkojnë ligjet në fuqi të RSH). Zonja në fjale është perkthyer e licensuar për gjuhën angleze. Bashkelidhur lista dhe bashkelidhur dokumenti me ane të të cilit zonja në fjale e pranon që e ka perkthyer dokumentin.

3. Interlogistic shpk duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.5 të kapacitetit Teknik të DST. Konkretisht subjekti Interlogistic shpk nuk provon me dokumentacion ligjor se disponon Makineri Shtypi offset me minimumi 2 ngjyra me format minimal 50x70 cm, Makineri Palosje format 50x70 (në dokumentat e paraqitura nga kjo shoqëri nuk përcaktohet në asnjë pikë të ketyre dokumentave formati i makines së palosjes) Makineri për numerator dhe Makineri për ngjytjen e kopertinave. Për plotësimin e ketyre kriterëve Interlogistic shpk ka paraqitur kontratë qeraje për keto makineri me subjektin Inpress shpk, dhe subjekti Inpress shpk i disponon keto makineri bazuar në një deklaratë noteriale. Duam të bëjmë me dije për AK pavarësisht e deklarates noteriale nr.2689 rep nr.887 kol/1 datë 12.12.2017 për dhurimin e sendeve, e cila ka sjelle veprime të tjera në kundërshtim me ligjin, si më poshtë:

1. Deklarata e hartuar nga Noteri M. B. m nr. 2689 rep nr.887 kol/1 datë 12.12.2017 midis Sh. N. dhe Shoqërisë PENA shpk, (ndryshuar emrin e shoqërisë nga PENA shpk në Inpress shpk me datën 24.01.2018) është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si më poshtë vijon: a) Dhurimi i sendeve qofshin të luajtshme apo të paluajtshme rregullohen nga dispozitat e kodit civil nën 761-771, dhe nuk rregullohen me ane të deklaratave noteriale të cilat nga pikpamja formale dhe nga përmbajtja rregullohen nga ligji nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar. b) Kontrata e dhurimit të parashikuar nga nën 761-771 të kodit civil përmban të drejtë dhe detyrime për paletë dhe është një marrëdhënie juridiko civile e njëanshme e cila ka detyrime për palen që dhuron dhe të drejtën e përfitimit dhe shprehjes së pelqimit për palen e cila përfiton sendin. c) Keto sende që deklaruesi Sh. N., deklaroi se i ka në pronësi por nuk i ka vërtetuar me dokumentacion pronesie si psh fatura blerje, kontrata blerje apo dhurimi, apo dokument tjetër ligjor të tjerë bashkelidhur deklarates. d) Sendet e dhuruara me deklarate nuk janë zhveshur nga e drejta e pronesisë së dhuruesit pasi ato mund të figurojnë të regjistruara në emër të dhuruesit në librat e regjistrimit të pasurive të luajtshme. e) Vetëm shprehja e vullnetit për noterit për dhurim nuk të zhvesh nga tagrat e pronarit pasi kontrata apo akti notarial duhet të depozitohet në regjistrin e barreve siguruese gjë e cila nuk konstatohet se është bërë. f) Bazuar në nën 764 paragrafi 3 i Kodit Civil, dhurimi i sendeve të luajtshme është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vlerën e tyre në kontratën e dhurimit. Kontrata quhet e lidhur në momentin e dorëzimit të tyre, gjë e cila nuk

vertetohet nga deklarata noteriale e paleve. 2. Bazuar ne Deklaraten Noteriale me nr.2689 rep nr.887 kol/1 date 12.12.2017, shoqeria PENA shpk (aktualisht shoqeria Inpress shp) ka pasqyruar nje Raport Vleresimi te dates 25.12.2017 me objekt: Vleresim te makineri shtypi dhe printimi, te hartuar nga Vleresuese ing. L. F. (D.) me nr.lic. Vp XXXX/1 dhe Nr. Cert; VLT.XX. Eksperte L. F. nuk permbush kriteret ligjore per te bere vleresimin e ketyre makinerive dhe pajisjeve te pasqyruara ne deklaraten noteriale dhe ne pasqyrat financiare te shoqerise PENA shpk (aktualisht shoqeria Inpress shpk), pasi Ekspertja nuk ka tagrin e vleresimit te ketyre makinerive sic eshte e percaktuar ne piken C te nenit 10, kreu III te VKM Nr. 712, date 12.10.2016. Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e licencimit te subjekteve per ushtrimin e aktivitetit ne fushen e vleresimit te pasurive te paluajtshme. Kjo e vertetuar nga licensimi i veprimtarise se saj dhe pasqyruar ne ekstraktin ne rregjistrin tregtar QKB. Eksperte L. F., ka vepruar ne kundershtim me Rregulloren per kriteret dhe procedurat e licencimit te subjekteve per ushtrimin e aktivitetit ne fushen e vleresimit te pasurive te paluajtshme, miratuar me VKM nr. 712, date 12.10.2016, te percaktuara si me poshte: Kreu I i dispozitave te pergjithshme si dhe Kreu III, Neni 10 Llojet e licencave .

1. Licenca eshte nje akt administrativ, qe lejon ushtrimin e veprimtarise ne fushen e vleresimit te pasurive te paluajtshme per individe dhe shoqeri.

2. Licencat per individe dhe shoqeri jepen per keto fusha vleresimi ne pasuri te paluajtshme: a) per ndertesa dhe toke truall;

b) per toke bujqesore, toke pyjore, kullote, livadh dhe toke te pafrutshme;

c) linja teknologjike, makineri e pajisje.

3. Licencat e individeve, per secilen fushe te vleresimit te pasurive te paluajtshme, jepen ne dy shkalle.

3. Ky raport vleresimi eshte pasqyruar ne Pasqyrat financiare te shoqerise PENA shpk (aktualisht shoqeria Inpress shpk), ne kundershtim me SKK te percaktuara si me poshte: SKK 1 KUADRI I PERGJITHSHEM PER PERGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE Njohja e aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve – Njohja eshte procesi i perfshirjes ne pasqyrat financiare, te nje zeri qe ploteson perkufizimin e nje aktivi, detyrimi, te ardhure ose shpenzimi dhe qe ploteson kriteret e meposhtme: (a) eshte e mundur qe çdo perfitim ekonomik ne te ardhmen, lidhur me kete ze, do te rrjedhe per ose nga njesia ekonomike; dhe (b) zeri ka nje kosto ose vlere qe mund te matet me besueshmeri. – Gabimet ne njohjen e nje zeri qe permbush keto kriteret nuk korrigjohen ne shenimet shpjeguese mbi politikat kontabel te perdorura apo ne sqarime te tjera te metejshme. Probabiliteti i perfitimit te ardhshem ekonomik – Koncepti i probabilitetit, si kriteri i pare i njohjes, i referohet shkalles se pasigurise qe perfitimet e ardhshme ekonomike te lidhura me nje ze te caktuar, do te rrjedhin tek ose nga njesia ekonomike. Vleresimet e shkalles se pasigurise te flukseve te perfitimeve te ardhshme ekonomike, kryhen mbi bazen e evidences se kushteve te disponueshme ne fund te periudhes raportuese, ne kohen e pergatitjes se pasqyrave financiare. Keto vleresime kryhen individualisht per zerat individualisht te rendesishem dhe per nje grup te madh te zerave individualisht te parendesishem Besueshmeria e matjes – Kriteri i dyte per njohjen e nje zeri eshte qe kosto ose vlere qe ai ka te mund te matet me besueshmeri. Ne shume raste, kostoja ose vlere e nje zeri njihet. Ne raste te tjera ajo duhet te vleresohet. Perdorimi i vleresimeve te arsyeshme eshte nje pjese thelbeshore e pergatitjes se pasqyrave financiare dhe nuk demton besueshmerine e tyre. Zeri nuk njihet ne pasqyrat financiare, ne rastet kur nuk mund te kryhet nje vleresim i arsyeshem.

SKK 5 “AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE” - I PERMIRESUAR

Modeli i rivleresimit – Nje klase AAM, vlere e drejte e se cilave mund te matet me besueshmeri, paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar me shumen e rivleresuar, e cila eshte vlere e drejte ne daten e rivleresimit, pakesuar ne periudhat ne vijim me amortizimin e akumuluar te mepasshem dhe

humbjet e akumuluar te mepasshme nga zhvleresimi. Rivleresimet duhet te kryhen rregullisht, ne menyre qe vlera kontabel te mos ndryshoje materialisht nga vlera qe do te rezultonte nese vleresimi i AAM-se, ne daten e raportimit do te behej me vleren e drejte – Nese vlera kontabel e nje aktivi afatgjate material rritet, si rezultat i rivleresimit, kjo rritje kreditohet drejtperdrejt ne kapitalet e veta ne zerin “Rezerva rivleresimi”. Por shuma e rivleresimit njihet si e ardhur ne pasqyren e te ardhurave, per sa kohe dhe ne ate mase qe ajo anullon humbjen nga rivleresimi i te njejtit aktiv ne periudhat kontabel paraardhese.

Nisur nga gjithe arsyetimi ligjor i bere me lart, çmojmë se çdo kontratë qeraje ndermjet subjekt Inpress shpk dhe Interlogistic shpk është totalisht e paligjshme dhe e pa vlerë. Si të tillë ne e konsiderojmë të pa plotësuar kriterin nga Interlogistik shpk dhe si pasojë këtkojmë skualifikimin e tij. Bashkelidhur per argumentimin dhe justifikimin e pretendimit tone gjeni: faqen e bilancit te kesaj shoqerie, deklaraten noteriale dhe listen e inventarit te perpiluar nga studio LURA.. [...]”

II.5.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“OE InfoSoft Office referuar vertetimit Nr. T01557253, date 15.11.2019 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve DTM, rezulton se ditën e dorëzimit te ofertes ka detyrime tatimore te papaguara. OE InfoSoft Office nuk ploteson kriterin e pervojave (furnizimeve) te meparshme, te ngjashme per zerat shtypshkrime”

II.5.1. Në datën 03.12.2019, operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 24177/2 Prot. datë 11.12.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “ Infosoft Office” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.5.3.Në datën 18.12.2019, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Ju drejtuam AK: Arsyeja per te cilen jemi skualifikuar nuk qendron.

Sipas kerkeses se percaktuar ne DST, kemi vetedeklaruar me pergjegjesi te plote se nuk kemi detyrime te papaguara. Bashkangjitur me kete ankese po ju paraqesim vertetim te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Drejtoria e Tatimpaguesve te Medhenj), me date 06.11.2019, ku sqarohet qe vlera e papaguar eshte nje gjobe prej 812.500 lekesh, dhe jo detyrim, dhe per kete gjobe kompania jone eshte ne proces gjyqesor apelimi administrativ. Pra. theksoj me qe behet fjale per nje gjobe dhe jo detyrim tatimor. Edhe ne ditën e sotme qe po hartojme kete ankese, ne formularin e gjeneruar nga faqja zyrtare Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, shikoni te detajuar qe akoma edhe sot kemi kete vlere prej 812.500 leke gjobe, ndersa eshte paguar i gjithe detyrimi. Bashkangjitur me kete ankese gjeni edhe formularin e mesiperm. Ne nenin 45 te LPP, Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve, pika 2, thuhet:

2. Çdo kandidat ose ofertues skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

Ne DST, ne Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, thuhet se ofertuesi duhet të deklarojë se: a) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Mos pagimi i detyrimeve është arsye për skualifikim, mospagimi i gjobave që janë në proces gjyqësor, nuk janë arsye për skualifikim. Për sa kohë që ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prere lidhur me këtë çështje, kjo nuk mund të jetë arsye për skualifikim. Referojmë vendimin unifikues nr. 4 datë 19.05.2011 të Gjykatës së Lartë, po ashtu udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008 të Ministrisë të Financave [...]si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH (ndryshuar me ligjin nr. 179/2013 datë 28.12.2013) neni 107[...]

Pra sic e shohim edhe nga faktet ligjore të mesipërme gjobat nuk përfshihen tek ato detyrime tatimore që duhet të shlyhen me parë se të ankimohen, por gjobat për sa kohë janë në proces ankimimi nuk konsiderohen si detyrim tatimor që duhet të parapaguhet. Bazuar në sa më sipër, lidhur me faktin që gjobat nuk janë arsye për skualifikim, kemi një vendim të KPP, Nr. 1412 Protokolli, Datë 24.08.2017 (bashkangjitur), ku KPP shprehet: Në bilanci mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirëpërdorimin e fondeve publike që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoba është në proces ankimimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës. Në këtë vendim të KPP përmenden të gjitha referencat ligjore ku bazohet ky arsyetim. Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” (ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013), neni 107, parashikon se nuk mund të nisë procesi gjyqësor për gjobat, pa paguar paraprakisht detyrimin. Kjo do të thotë që, për sa kohë jemi në proces gjyqësor, i kemi paguar të gjitha detyrimet. Legjislacioni shqiptar parasheh dhe i jep të drejtën subjekteve të ndjekin një proces apelimi administrativ, kjo do të thotë që jemi plotësisht në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe nuk kemi bërë asnjë shkelje në pagimin e detyrimeve. Në i kemi paguar të gjitha detyrimet. Gjykata nuk është shprehur ende në lidhje me çështjen e gjobës. Kompania jone e ka kaluar në gjykatë këtë çështje, sepse janë bazat për të pretenduar që kjo është një vlerë që nuk na takon ta paguajmë. Asnjë ligj nuk i jep asnjë AK të drejtën të gjykojë, dhe aq më pak të vendosë, në lidhje me një çështje që është në proces gjyqësor. Për sa kohë që legjislacioni shqiptar, në këtë rast gjykata, nuk është shprehur, as ju si AK nuk mund të vendosni që kemi detyrime të papërbushura. Procesi gjyqësor që po ndjekim, me shumë gjasa mund të përfundojë me një vendim në favorin tonë, dhe mund të arrihet në konkluzionin që nuk duhet ta paguajmë atë gjobë. Ju “na shpallet fajtor” pa gjyq dhe na penalizuar, edhe pse ligjrisht nuk e kemi këtë të drejtë. LPP ju jep të drejtën që të vertetoni të gjithë informacionin e mesipër, pranë Drejtorisë Tatimore.

Përgjigja e AK: Ashtu sikurse pranohet edhe nga ju, referuar neni 45 të LPP si edhe DST, kriteret e vecanta për kualifikim, ofertuesi duhet të ketë përbushur të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve sipas legjislacionit në fuqi. Sa më sipër referuar parashikimeve të neni 6, pika 3 e Urdhrit të Ministrisë të Financave nr 24, datë 02.09.2018 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatevonesat dhe gjobat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore dhe legjislacionit për taksat vendore. Pra qartësisht gjobat janë pjesë e detyrimit tatimor dhe mos pagimi i tyre sjell mospërbushje të kriterit kualifikues të parashikuar në DST.

Edhe një herë theksojmë: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr 24, që përmendet në përgjigjen e AK i perket datës 02.09.2008. Pas këtij udhëzimi, ka pasur një vendim unifikues nr. 4 datë 19.05.2011 të Gjykatës së Lartë i cili shprehet se: “Me “detyrim tatimor”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë në nenin 63 nënkupton “tatimin,

kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj. Dallohet qartësia në ligj që, për t'u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ NjoftimVlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat. Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ."

Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSh" (ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013), neni 107 parashikon se:1.Tarimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës I të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore. 2. Shuma e pagueshme ose suma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave parashikon se: "Shuma e detyrimit për t'u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjobat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi".

Bazuar në keto referenca ligjore, në 24.08.2017, ju vete (Komisioni i Prokurimit Publik) keni marrë një vendim (nr 1412), ku beni një interpretim të gjere të kesaj ceshtje dhe dilni në perfundimin se: Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se "ka detyrime tatimore të pashlyera", kur me këto të fundit nënkuptohen gjoba të cilat janë në proces ankimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Komisioni vlerëson të adoptojë një interpretim të ngushtë e teleologjik të togfjalëshit "detyrimet për pagimin e tatimeve " të parashikuar nga neni 45, pika 2, gërma "dh " i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (të ndryshuar), në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik. Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoba është në proces ankimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës. AK në vendimin e skualifikimit është bazuar në një udhëzim të Vitit 2008, pa marrë parasysh vendimin e mepaseshem rregullues të këtij udhëzimi, të nxjerre nga Gjykata e Lartë në vitin 2011, dhe as vendimin e KPP të Vitit 2017, ku behet interpretimi i udhëzimit nr 24 të Ministrisë së Financave nën frymën e LPP, si dhe rregullohet ndikimi i këtij udhëzimi në procedurat e prokurimit. Qartësisht ju vete (KPP) me vendim nr. 1412, datë 24.08.2017, keni përcaktuar një interpretim të udhëzimit nr 24 të Ministrisë së Financave nën frymën e LPP, dhe keni arritur në një përfundim përgjithësues se: Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoba është në proces ankimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës. Në keto kushte skualifikimi ynë nga ana e AK është i padrejtë dhe në shkelje të dispozitave ligjore.

2. Arsyeja e detyrimit për të cilën jemi skualifikuar:

OE Infosoft Office nuk plotëson kriterin e parësor (furnizimeve) të meparshme të ngjashme për zërat shtypshkrime. Jo vetëm nuk qëndron, por është në shkelje të hapur të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, dhe kërkesave që ju vete kishit përcaktuar në DST. Kërkesa në DST ishte:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlера duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 50,000,000 (Pesëdhjetë milion) leke. Në rast se kontrata është kryer me ente publike: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rast se kontrata është kryer me sektorin privat: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në Rregullat e Prokurimit Publik, neni 27, Kontratat e mallrave, thuhet: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlера e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Objekti i tenderit është “Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a”, pra një objekt i vetëm dhe jo i ndarë në lote. Fondi i tenderit është 126,736,606 leke pa TVSH, një i vetëm, dhe nuk ka ndonjë përcaktim sesa është fondi për shtypshkrimet. Në ankesën që bëri OE “Kristalina KH” sh.p.k., përpara zhvillimit të procedurës, përmes së cilës kerkoi ndarje të tenderit në lote, ku shtypshkrimet të prokuroheshin si lot me vetë, as ju si AK dhe as KPP, nuk pranuat këtë ndarje. Madje KPP në vendimin e saj u shpreh se: Në rastin konkret, ndarja në lote të procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankuesit, një lot artikujt standart kancelarik dhe një lot artikujt kancelarik të cilat realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb të gjithë artikujt objekt prokurimi i përkasin të njëjtës kategorie produktesh. Kërkesa juaj në DST për furnizime të mëparshme të ngjashme nuk ka asnjë ndarje të vecantë për shtypshkrimet, i referohet të gjithë objektit të tenderit dhe të gjithë fondit në teresi, pa shprehur asnjë kërkesë për të ndarë shtypshkrimet me vetë. Në asnjë pikë të DST apo të Rregullave të Prokurimit Publik, apo të LPP, nuk përcaktohet që furnizimet e ngjashme të mëparshme analizohen dhe përllogariten për çdo të. Përsa kohe që kancelari dhe shtypshkrime janë të njëjta kategori produktesh, edhe furnizimet e ngjashme të mëparshme llogariten të gjitha bashkë, pa ndarë me vetë zerin e shtypshkrimeve, aq më tepër që ju vetë si AK nuk pranuat të ndanit shtypshkrimet si objekt me vetë, edhe kur kjo gjë ju kerkua nga OE. Nëse për shtypshkrimet kerkonin furnizime të ngjashme të vecanta, duhet të kishit përcaktuar sa është fondi për shtypshkrimet, dhe sa përqind të këtij fondi duhej të ishte vlера e furnizimeve të mëparshme, sepse ligji juaj le në dorë juve si AK të përcaktoni një përqindje që nuk duhet të kalojë 40% të vlerës së fondit për këtë zero. Ose duhej të kishit përcaktuar një vlerë konkrete për shtypshkrimet. Ashtu siç keni përcaktuar vlerën 50.000,000 (Pesëdhjetë milion) leke për të gjitha furnizimet e mëparshme në total, duhej të përcaktonit sa duhej të ishte vlера e shtypshkrimeve. Për sa kohe ju nuk keni bërë asnjë kërkesë për shtypshkrimet, nuk keni përcaktuar asnjë vlerë që duhej të plotësojnë furnizimet e mëparshme, atëherë nuk ka as bazë ligjore, as kuptim, as llogjikë, të na skualifikoni se nuk kemi plotësuar një kërkesë (apo një vlerë) që ju nuk e keni përcaktuar. Në kemi paraqitur një mori furnizimesh të mëparshme ku vlера pa tvsh të artikujve të letres, kancelarise, shtypshkrimeve, artikujve të loguar, shkon në mbi 70 miliona, duke plotësuar dhe kapërcyer kërkesën tuaj për furnizime të mëparshme në vlerë 50 miliona leke. Të gjithë keto

artikuj, nga ju si AK dhe nga KPP, jane cilesuar si artikuj te ngjashem apo e njejta kategori produktesh, keshtu qe kemi plotesuar me se mire kerkesen per furnizime te ngjashme.

Pergjigja e AK: neni 28 pika 1 e VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht "Natyra e sherbimeve duhet te shprehet qarte ne termat e references, ku perfshihet objekti, qellimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore te sherbimit qe do te kryhet." Ndersa pika 3 e nenit me siper parashikon shprehimisht "Per te provuar pervojen e meparshme, AK kerkon deshmi per sherbimet e meparshme, te ngashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlere e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40% te vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit". Ne vijim, ne nenin 46, pika 1, germa "b" te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese". Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Neni 53, pika 3, e ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne AK per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vërtetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim per AK eshte e rendesishme te provohet qe OE zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me objektin e prokurimit dhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Referuar ne menyre specifike objektit te prokurimit, kriteret te percaktuara nga AK si dhe specifikimeve teknike, gjykojme se ato ne teresine e tyre shprehin qarte kerkesen e AK per natyren e mallrave / produkteve objekt prokurimi, i cili ne rastin konkret eshte blerja e artikujve kancelarik te cilat per te permbushur kerkesat e AK duhet te realizohen nepermjet shtypshkrimit, si dhe blerjen e artikujve te ndryshem dhe standarte kancelarik. Pavaresisht faktit se ne thelb te gjithë artikujt objekt prokurimi i perkasin nje kategorie te ngjashme produktesh, ne analize te te gjithë dokumentacionit te paraqitur ne permbushje te kriterit per kontrata te ngjashme, AK gjykon se faturat e paraqitura nga ju, nuk mund te konsiderohen furnizime te ngjashme pasi nuk permbajne karakteristiken dhe specifiken e kerkuar nga AK ne DST per menyren e realizimit te furnizimit me artikuj standarte kancelarike, e cila eshte nje veprimtari ekonomike-tregtare teresiht e ndryshme nga ajo e furnizimit te artikujve kancelarik te cilat, per te permbushur kerkesat e AK duhet te realizohen nepermjet shtypshkrimit. Ne menyre te vecante OE "Infosoft Office" shpk., ka mungesa te eksperiencave te meparshme te ngjashme ne furnizimin me artikuj kancelarik qe sipas kerkesave te AK duhet te realizohen nepermjet shtypshkrimit, te cilat zene nje volum te qenesishem si ne vlere, ashtu edhe ne sasine e kerkuar ne DST objekt prokurimi. Nga sa me siper si dhe nje sere vendimesh te KPP ne te cilen ne menyre konstante percaktohet se: AK ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperienca te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithë zerat e puneve, mallrave/sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem

ne kontratat e realizuara me pare. Ne kete kuptim AK nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale per te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara. AK arrin ne konkluzionin se bazuar ne faturat e paraqitura nga OE “Infosoft Office” shpk., si dhe dokumentacionin e paraqitur ne teresi, ky OE nuk permbush kriterin e furnizimeve te ngjashme ne furnizimin me artikuj kancelarik qe sipas kerkesave te AK duhet te realizohen nepermjet shtypshkrimit, duke mos pasur eksperienca dhe veprimtari te meparshme te ngjashme persa i perket tregtimit te artikujve kancelarike qe duhet te realizohen nepermjet shtypshkrimit, te cilat pavaresisht ngjashmerise se “llojit” te produkteve me artikuj kancelarike standart, kane karakteristika te ndryshme persa i perket i) veprimtarise ekonomike-tregtare per realizimin e ketij furnizimi; ii) organizimit strukturor dhe aftesise organizative te OE, si dhe iii) pervojes se duhur te meparshme, duke mos vertetuar keshtu se gezon te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Pergjigja e mesiperme eshte nje loje fjalesh, e papergjegjshme, pa nje argumentim ligjor qe te lidhet me arsyen e skualifikimit. AK i referohet vendimeve te KPP, por nuk shprehet fare per cilat vendime konkretisht duke e lene teresisht te paqarte nese ato vendime kane ngjashmeri me problematiken qe po ankimojme. Fakti qe nuk jepen referenca te sakta per cilat vendime behet fjale, le te dyshosh per ekzistencen dhe permbajtjen e ketyre vendimeve. AK flet ne pergjigjen e saj per dy grupe produktesh, kancelari dhe kancelari te realizuara nepermjet shtypshkrimeve (ky i dyti , term i padegjuar me pare nga ne) dhe po vete pranon se te gjitha artikujt i perkasin nje kategorie te ngjashme produktesh : “ne thelb te gjitha artikujt objekt prokurimi i perkasin nje kategorie te ngjashme produktesh” dhe bile i konsideron te dyja kancelari. Ne vazhdim, ben nje lloj ndarje, qe nese do te ishte e vertete , duhej te bente :Ndarje ne lote te procedures. Ndarje fondi per secilin grup. Ndarje e vleres se kontratave te ngjashme te kerkuara per secilin grup. Vete kerkesa ligjore te ciles i referohet AK, flet per kontrata te ngjashme, jo identike. Nder kontratat dhe faturat e ngjashme qe kemi paraqitur, kemi pasur disa milione vlere kancelari te realizuar nepermjet shtypshkrimeve (nese do te perdorim termin e shpikur nga AK). qe perbehen nga artikuj si: blloqe, libra protokolli, magazine, mandate arketimipagese, urdher dorezime, blloqe sherbimesh, procesverbale, blloqe hyrje dalje e shume e shume produkte te tjera, te permasave dhe llojeve te ndryshme, te gjitha keto, te personalizuar sipas kerkesave te institucioneve, produkte te loguara si dosje, zarfa, letra te loguara te formateve te ndryshme etj. Te gjitha keto produkte, realizohen nepermjet procesit te shtypshkrimit dhe ne asnje menyre tjeter. Kemi paraqitur dhe disa milion te tjera, pervoja te ngjashme, qe te gjitha me produkte kancelarie. Ne total, mbi 70 milion Leke eksperienca. Si eshte e mundur qe keto eksperienca nuk konsiderohen te ngjashme nga AK????!!!!

Nese kerkon dhe pranon per eksperienca te ngjashme, vetem produkte format OSHE, atehere po kerkon pervoja identike dhe jo te ngjashme, ne kundersizim te thelle me LPP, dhe ne kufizim te pjesemarrjes. AK ka kerkuar pervoja te ngjashme ne vlere 50 milion. Asnje sqarim shtese se si duhet te ndahet kjo vlere per dy grupe produktesh!!! Ne fakt, nuk kishte si ta bente, pasi edhe AK edhe KPP gjykuan qe te gjitha produktet jane te ngjashme dhe i perkasin te njejtit grup. Lidhur me aftesite teknike per te cilat flet AK, e kemi vertetuar se zoterojme kualifikimet e nevojshme teknike-profesionale, makinerite etj perderisa kemi realizuar, prodhuar dhe paraqitur te gjitha mostrat e produkteve, sipas kerkeses ne dokumentat e tenderit. Theksojme qe AK, ne funksion te verifikimit te kapaciteteve te OE, kishte vendosur nje seri kriteresh teknike, te cilat jane plotesuar teresisht nga OE, gje qe verteton se kemi te gjitha aftesite teknike per realizim te kesaj kontrate. AK ne pergjigjen qe na kthen shprehet: AK gjykon se faturat e paraqitura nga ju; nuk mund te konsiderohen furnizime te ngjashme pasi nuk permbajne karakteristiken dhe specifiken e kerkuar nga AK ne DST per menyren e realizimit te furnizimit me artikuj standarte kancelarike, e cila eshte nje veprimtari ekonomike-tregtare teresiht e ndryshme nga ajo e furnizimit te artikujve kancelarik te cilat, per te

permbushur kërkesat e AK duhet të realizohen nepermjet shtypshkrimit. AK pretendon që faturat tatimore të paraqitura nga ana jone duhet të permbanin menyren e realizimit të furnizimit, nderkohe që faturat tatimore janë dokumenta shteterore me format dhe permbajtje të percaktuara nga ligji. Faturat tatimore permbajne vetem ato të dhena që percakton ligji (emertime, sasi, cmime, vlere, tvsh etj). Si perfundim, në kundërshtim të plote me vendimin tuaj, që percakton se të gjithë artikujt objekt i këtij prokurimi, janë të ngjashëm dhe i perkasin të njëjtes kategori, në vendimin e tij, në një ndarje në grupe, teresisht evazive, pa percaktuar akoma as tani se cila është Vlera e pervojave të ngjashme që do të perkiste grupit të kancelarive të realizuar nepermjet shtypshkrimeve. AK ka detyrimin të percaktojë kërkesa të qarta dhe të detajuara, për të mos krijuar konfuzion tek OE dhe për të dhënë mundësinë KVO të jetë objektive, e paanëshme dhe të mos diskriminojë Operatorët. Nderkohe që të gjitha argumentet tona po i mbështesim në ligj dhe në vendimet e institucioneve me të larta si Gjykata e Lartë dhe KPP, argumentimet e AK, jo vetëm që nuk kanë asnjë mbështetje dhe reference ligjore, por janë në kundërshtim të plote me LPP dhe me vendimin nr. 1428, datë 23.08.2019, që KPP ka marrë pikerisht për këtë procedurë, ku shprehet që të gjithë artikujt janë të ngjashëm. AK. me skualifikimin e ofertës sone, ka dale teresisht në kundërshtim, përveç të tjerave, të vendimeve të KPP dhe konkretisht: Për ceshtjen e parë, në kundërshtim me vendimin Tuaj nr 1412, datë 24.08.2017. Për ceshtjen e dytë, në kundërshtim të vendimit Tuaj nr 1428, datë 23.08.2019 [...]"

II.6.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"OE Albdesign PSP nuk plotëson kriterin e pervojave (furnizimeve) të mëparshme, të ngjashme për zërat kancelari.

OE Albdesign PSP nuk paraqet Certificate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësive dhe Certificate ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor në përputhje me objektin e prokurimit. Certificate ISO kanë për objekt vetëm shtypshkrimet dhe jo kancelaritë.

Referuar skedës teknike të produktit leter A4 të dorëzuar me nr. IK Spec 002, datë 01 shtator 2017, rezulton se bardhësia CIE e deklaruar nga vete prodhuesi është 172 +/-3, kjo në kundërshtim me specifikimet teknike, ku bardhësia e letres kerkohet CIE - ≥ 172 ."

II.6.1. Në datën 06.12.2019, operatori ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Interlogistics" sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 24508/3 Prot. datë 13.12.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Albdesign PSP" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.6.3.Në datën 19.12.2019, operatori ekonomik ankimues "Albdesign PSP" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Nga shoqëria jone për permbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme kemi paraqitur një sërë kontratash e faturash të ngjashme me objektin e prokurimit. Kemi paraqitur fatura tatimore për subjekte dhe ente të ndryshme për produktet si vijon :

Leter A4, Kupona, Zarfa
Kontrata familjare
Formulare AKEP GSM
Flete palosje
Akhenda
Libreza telefoni
Formulare AKEP GSM, sim stiker
Leter me koke albtelecom .
Canta letre te branduara
Mandate me leter kimike me dy kopje
Mandate me dokument me 3 kopje
Mandat depozitimi cash pa numeruara
Bllok dergese vlerash
Zarfa me logo
Fasheta per kartemonedha
Bllok dorezim vlerash
Bllok formular urdher transferte
Mandate dorezimi cash i panumuruar
Etiketa dergese fondesh ne BSH Transferim fondi
Mandat arketimi drop box
Fasheta per kartmonedha
Order
Printim
Grade 1 tooklitbaze mesimore per te gjitha shkollat e republikes
Grade 2 tooklit baze mesimore per te gjitha shkollat e republikes
Grade 3 tooklit baze mesimore per te gjitha shkollat e republikes
Grade 4 tooklit baze mesimore per te gjitha shkollat e republikes
Grade 5 tooklit baze mesimore per te gjitha shkollat e republikes
Distribution shperndarje ne te gjitha shkollat e vendit Blloqe BKT me leter kimike
Autorizim per debitim direkt
Kontrate per celje llogarie
Dergesa vlerash BSH
Kontrate per celje llogarie
Bllok pasqyre per gjendje arke
Blloqe prepaid
Stilolapsa
Leter fotokopje
Llastiqe
Tapete mausi
Gershere
Tela kapesse staples
Korrektor
Markera
Vizore
Lapustila
Dosje me mekanizem
Makine llogaritese
Toner printeri

Stilolapsa

Prodhim karta rezidenti

Printim dhe shperndarje e JA K9 toolkits per vitin akademik 201-2018 dhe 2015-2019

Blerje dokumentacioni Sherbim per printimin e flete detyrimeve dhe prodhim dokumentacioni per vitin 2017

Shtypshkrime

Pulla me holograme, etj

Sikurse vihet re eshte nje game e shumellojshme produktesh jo vetem shtypshkrime por edhe kancelari, me ente publike dhe private.

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, "Kontratat e Mallrave", parashikohet se "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kriteret për kualifikim vendosen që t' i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit

me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Nga dorezimi i dokumentave të dorëzuar nga shoqëria jone për këto kriter për kontratat e ngjashme Albdesign PSP shpk në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, theksojmë se kontratat e paraqitura dhe faturat tatimore janë deshmime se nga ana e shoqërisë sone janë kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit. Mallrat objekt prokurimi të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë shërbime printimi me sasitë perkatëse për çdo produkt si edhe kancelarit me sasitë perkatëse. Referuar objektit dhe faturave / preventivave të kontratave të paraqitura nga shoqëria jone rezulton se këto kontrata janë të realizuara me sukses dhe në përputhje me afatet e përcaktura. Referuar dëshmive të eksperiencës së mëparshme të dorëzuar dhe të realizuara kemi provuar se kemi furnizuar mallra të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur, shoqëria jone ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 9 të dokumentave të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme. Theksojmë se për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këtë kuptim, Autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, eksperiencat e ngjashme të paraqitura nga shoqëria jone jo vetëm për nga krahasueshmëria e kontratave janë të ngjashme por edhe për nga natyra e kontratës por dhe për sa i përket elementëve konkretë të mallrave të furnizuara me anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, shoqëria jone ka vërtetuar se ka kryer me sukses, furnizime të ngjashme në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit, duke tejkaluar edhe vlerën e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Duam të sjellim në vëmendje këtu autoritetit kontraktor se për këto procedure prokurimi ka pasur ankesa edhe për kriteret e hartuara nga AK dhe në përfundim të shqyrtimit nuk është pranuar një pretendim që lidhet me ndarjen në lote për vec shtypshkrimet dhe vec kancelaritë, por KPP nuk e ndau këto procedure duke konsideruar dhe argumentuar se pjesa më e madhe e kancelarive që janë përfshirë në këto procedure prokurimi janë me natyrë shtypshkrime dhe për këtë arsye nuk bëri edhe ndarjen në lote duke konsideruar si një procedure të tjerë meqë ato pak kancelari të kërkuara janë të natyrës shtypshkrime, por që nga ana tjetër pavarësisht kësaj në kemi paraqitur edhe disa kontrata /fatura për kancelari. Për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk ka bërë vlerësim të saktë mbi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria jone që në fakt ka të bëjë me kontrata të ngjashme. Autoriteti kontraktor në këtë vlerësim ka dalë në kundërshtim edhe me vetë veten e tij pasi pas ankesës për kritere për ndarjen e procedurës në lote për kancelari dhe shtypshkrime si lote me vetë në të njëjtën procedure prokurimi ai nuk ka pranuar që të ndahet si procedure me vetë kancelarite nga shtypshkrimet kështu që nuk ka kuptim të ndajë procedurën e ta bëjë me lote në vlerësim për ta konsiderojë si të ndarë kancelarite dhe shtypshkrimet si dy procedura me vetë gjatë vlerësimit të dokumentacionit duke kërkuar kontrata të ngjashme për secilin lloj procedure me vetë. Qëndrim i mbajtur ky edhe në shumë vendime të KPP si organi më i lartë në fushën e prokurimeve si KPP

626/2019 date 26.09.2019. Ne perfundim mendojme se kjo arsye skualifikimi e dhene nga autoriteti kontraktor nuk qendron.

2. Per arsyen e skualifikimit: OE Albdesign PSP nuk paraqet Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise dhe Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikimet ISO kane per objekt vetem shtypshkrimet dhe jo kancelarite.

Ne dokumentat e tenderit Shtojca 9 autoriteti kontraktor ka kekruar kriterin : 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise, te vlefshme e leshuar nga nje organ i akredituar. Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, te vlefshme e leshuar nga nje organ i akredituar. Ne rastin e bashkimit te Operatoreve, secili anetar duhet te paraqese ISO ne perputhje me zerat qe do te marre persiper te furnizoje.

Shoqeria jone ne sistemin e prokurimit ka paraqitur certifikatat ISO te kerkuara 9001 dhe 2014 me objekt gjithepershires per diznejim dhe prodhim te gjitha produkteve shtypshkrime, botime, shtypshkrime me element sigurie, materiale promocionale, materiale te paketimit, etiketa, printim, fatura dhe zarfim, materiale reklamuese, prodhim dhe montim panele reklamuese si dhe tregtim i materialeve prej kompoziti dhe kapake dhe zgara gize.

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, "Kontratat e Mallrave", parashikohet se "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve". Ne rregullat e prokurimit publik (VKM 914/2014) eshte percaktuar qe AK mund te percaktoje kriteret qe lidhen me cilesine e shoqerise.

Autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatori vetem te disponoje certificate iso 9001 dhe 2015 dhe nuk ka kerkuar ne asnje vend te DST qe keto iso te jene per kancelarite, nderkohe qe procedura e prokurimit ka te beje me shtypshkrime dhe kancelarite jane nje element dytësor dhe me karakter shtypshkrime, megjithate pavaresisht se ne objektin e certifikatave iso qe ka shoqeria jone eshte nje fushe gjithepershires dhe nuk eshte specifike apo eksplicite per kancelarite nderkohe qe kancelarite e kerkuara nga autoriteti kontraktor ashtu sic thame edhe me lart jane me teper me natyre shtypshkrime dhe perfshihen ne kete fushe te shtypshkrimeve, pasi per kete shkak edhe KPP ne vendimin qe ka dhene per modifikimin e kriterëve pikerisht per kete arsye nuk e ka ndare objektin e prokurimit ne lote duke e konsideruar si produkte te njejta pra kancelarite qe kerkohen ne kete procedure prokurimi nuk jane kancelari te mirefillta por kancelari me natyre shtypshkrime. Objekti i veprimtarise sone perfshin ndermjet te tjerave shtypshkrime dhe jo vetem por edhe diznejim dhe prodhim te gjitha produkteve shtypshkrime, botime, shtypshkrime me element sigurie, materiale promocionale, materiale te paketimit, etiketa, printim, fatura dhe zarfim, materiale reklamuese, prodhim dhe montim panele reklamuese si dhe tregtim i materialeve prej kompoziti dhe

kapake dhe zgara gize, pra nje veprimtari gjithëpërshiresë ku futen edhe produkte kancelarike që në rastin konkret keto kancelari të kerkuara nga AK përshihen me natyrë shtypshkrime. Autoriteti kontraktor nuk duhet të vlersojë nje oferte mbi kriteret të pakërkjuara sepse vlerësimin duhet ta bëjë vetëm mbi ato kriteret të kerkuara në DST. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimi por, edhe në përputhje me volumen e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Me dokumentacionin e paraqitur, shoqëria jone ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 9 të dokumentave të tenderit për sa i përket certifikatave ISO pasi objekti i këtyre certifikatave ashtu siç përshkruam më sipër është për një fushë të gjere të shtypshkrimeve duke përfshirë edhe ato kancelarike të kerkuar nga autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi. Qëndrim i mbajtur ky edhe në shumë vendime të KPP si organi më i lartë në fushën e prokurimeve. Edhe kjo arsye skualifikimi e dhënë nga autoriteti kontraktor nuk qëndron për shoqërinë tonë.

3. Për arsyen e skualifikimit "Referuar skedës teknike të produktit leter A4 të dorëzuar me nr. IK Spec 002, datë 01 shtator 2017, rezulton se bardhesia CIE e deklaruar nga vete prodhuesi është 172+/-3, kjo në kundërshtim me specifikimet teknike, ku bardhesia e letres kërkohet CIE - ≥ 172 . Në SPE nga shoqëria jone është depozituar dokumentacioni në lidhje me "letren për skedën teknike ku konstatohet se CIE është 172+/-3 ashtu siç edhe AK ka dhënë në arsyen e skualifikimit. Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka kerkuar që bardhesia e letres të jetë CIE - ≥ 172 . Autoriteti kontraktor është nxitur në skualifikimin e shoqërisë sone pa u përqendruar në specifikimet teknike dhe dokumentacionin e parasqitur nga shoqëria jone pasi ai vete ka kerkuar që CIE të jetë CIE - ≥ 172 . Nga në është paraqitur që bardhesia do të jetë 172+/-3 pra është në përputhje me specifikimet teknike nëse autoriteti do të ishte përqendruar me shumë. AK ka kerkuar bardhesi më të madhe dhe baraz me 172 nderkohe që në e kemi paraqitur 172+/-3 pra përshihet në këtë diapazon parametri nga 172 deri në 176 duke e plotësuar kushtin e vënë në DST që bardhesia të jetë e barabartë ose më e madhe se 172. Gjithashtu shoqëria jone ka nënshkruar edhe deklaratën për shtojcën e specifikimeve teknike ku kemi deklaruar se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor ka në dispozicion në bazë të ligjit të prokurimit publik dhe nenit 62 të tij që të monitorojë zbatimin e kontratës dhe të japë penalizimet konkrete nëse në nuk do të realizojmë kontratën duke dorëzuar produktet sipas kërkesave të AK. Autoriteti kontraktor nuk duhet të skualifikojë pa shqyrtuar me seriozitet të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria jone. Edhe kjo arsye skualifikimi e dhënë nga AK nuk qëndron.

4. Nga ana tjetër rezulton se AK ka kualifikuar shoqerine "Interlogistic" sh.p.k. e cila ka mungesë dokumentacioni dhe nuk i ka paraqitur ato në përputhje me kriteret e kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ka mbajtur një qëndrim diskriminues duke shkelur parimet e ligjit të prokurimit publik atë të transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë etj. Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë këtë shoqëri se ajo ka shumë mungesë dokumentacioni dhe dokumenta që nuk janë në përputhje me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit.

4.1 Operatori ekonomik Interlogistic nuk plotëson kriterin për ISO sepse ato që ka paraqitur nuk e kanë në objekt veprimtarinë e prodhimit të shtypshkrimeve kur objekti i prokurimit është shtypshkrime por e ka vetëm shitje blerje shtypshkrime. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 autoriteti kontraktor ka kërkuar kriterin : 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Certifikatë ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, të vlefshme e leshuar nga një organ i akredituar. Certifikatë ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, të vlefshme e leshuar nga një organ i akredituar. Në rastin e bashkimit të operatoreve, secili anëtar duhet të paraqesë ISO në përputhje me zërat që do të marrë për shërbime të furnizimit. Kjo shoqëri kemi dyshimet tona se certifikatat ISO të kërkuara 9001 dhe 2014 nuk janë për objektin e kësaj procedure prokurimi pra për shtypshkrime por janë vetëm për shitje dhe blerje shtypshkrime. Kjo shoqëri këto certifikata përveç objektit që nuk e ka me atë të procedurës së prokurimit, nuk i ka të leshuara këto certifikatat nga organizma të akredituar sipas manualit të publikuar në faqen e APP, si edhe nuk janë leshuar nga organizma të cilat ato vete ta kenë këtë objekt të veprimtarisë së tyre pra shoqëritë ose organizmat që kanë leshuar këto certifikata nuk janë të akredituara dhe nuk e kanë si objekt të veprimtarisë së tyre veprimtarinë për prodhim shtypshkrime. Për këtë arsye kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik të kualifikuar për mosplotësim të kriterëve për kualifikim të vendosur nga AK.

Në nenin 46, pikë 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Në nenin 27, pikë 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, "Kontratat e Mallrave", parashikohet se "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve". Në rregullat e prokurimit publik (VKM 914/2014) është përcaktuar që AK mund të përcaktojë kritere që lidhen me cilësinë e shoqërisë. Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori të disponojë certifikatë ISO 9001 dhe 14001, nderkohe që procedura e prokurimit ka të bëjë me shtypshkrime dhe kjo shoqëri nuk e ka objektin e shtypshkrimeve si veprimtari në këto certifikata kur pjesa më e madhe e produkteve të këtij procesi prokurimi ka të bëjë me shtypshkrimet pasi edhe ato pak kancelari që kërkojnë janë me natyrë shtypshkrime dhe përfshihen në këtë fushë. Në lidhje me certifikatën ISO 9001 sikurse shihet nga

certifikata e akreditimit e leshuar nga organizmi akreditues grek ESYP per kodin EA 09 dhe 29 si me poshte per: Kodin EA 09 i cili permbledh: "SHTYPSHKRIME DHE SHERBIMET E LIDHURA ME TO. Ky grup përfshin shtypjen e gazetave, librave, periodikëve, formave tregtare, kartolinave dhe materialeve të tjera; Përfshihen gjithashtu aktivitete mbështetëse siç janë ruajtja e librave, përgatitja e pllakave, teksti dhe imazhi. Shtypja mund të bëhet duke përdorur teknika dhe materiale të ndryshme. " Nderkohe qe kompania Interlogistic ben vetem aktivitet tregtar. Gje qe verifikohet lehtesisht pasi mendojme se duhet te verifikohen te gjitha listepagesat duke qene se kemi dyshime se kjo kompani nuk ka asnje punonjes ne profilet e shtypshkronjes duke e kontrolluar me kodet perkatese qe kane keto listepagesa per secilin te punesuar. Gjithashtu ne lidhje me ISO 14001, nga humultimi ne internet konstatojme dhe kemi dyshimet tona se instituti qe ka bere certifikimin e shoqerise nuk eshte i akredituar per ISO 14001 Shtypshkrime nga organizmi akreditues i shtetit perkates. Certifikatat e akreditimit per ISO 9001 dhe ISO 14001 bashkengjitur kesaj ankese te mara nga humultimi ne internet e vertetojne kete konstatim tonin. Ne kete kontekst kemi dyshime te forta edhe ne vete ligjishmerine e procesit te certifikimit te kesaj kompanie

4.2. Operatori ekonomik Interlogistic nuk ploteson kriterin per makinerite pasi ne dyshojme se per makinerine 50x70 nuk ka dokument zhdoganimi te apostiluar. Makinerite e marra me qira nga kompani te huaja nuk kane kaluar kufirin shqiptar dhe nuk eshte paraqitur asnje dokument doganor per regjimin e perkohshem ne kushtet kur mjeti kalon doganen. Ne VKM 134 date 7.3.2003 "Per vertetimin dhe legalizimin e dokumentave te leshuara ne Republiken e Shqiperise, per perdorim jashte vendit dhe te dokumentave te huaja, per perdorim brenda vendit", eshte percaktuar qe duhet legalizuar dokumentat e huaja. Ne kete VKM percaktohet qe: 4. Dokumentet e autoriteteve te huaja, qe do te përdorën brenda vendit, legalizohen ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara ne Tirane, legalizohen ne Ministrinë e Punëve te Jashtme. 5. Ne vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi te akredituar, legalizimi i dokumenteve te huaja, te legalizuara me pare nga Ministria e Jashtme e vendit te origjinës, kryhet ne Ministrinë e Punëve te Jashtme. Pra ne rastin kur kemi dyshime se shoqeria Interlogistic ka paraqitur kontrate qeraje per mjetet me nje shtet jashte Shqiperise, atehere ai per te vertetuar keto mjete i eshte kerkuar edhe kontrate qeraje, e cila ne rast se mjeti eshte marre me qera nga jashte Shqiperise atehere ai duhet shoqeruar me akt zhdoganimi qe eshte nje dokument i leshuar nga organ publik i cili nga vetja e vet duhet te jete nje dokument i legalizuar sipas VKM 135/2003, ne menyre qe te vertetoje pronesine por edhe qe te jete e vlefshme si dokument. Kerkojme qe autoriteti kontraktor te beje nje verifikim nese kontrata te qerase per mjete qe jane lidhur me pronar te mjeteve pra qeradhenes jashte shtetit te shqiperise a ka paraqitur dokument doganor te rregullt pra te legalizuar si edhe dokument doganor me regjim te perkoheshem. Referuar legjislacionit ne fuqi ekziston nje regjim i perkoheshem ne rastin e qeradhenies mes dy shteteve dhe per kete fakt te verifikohet nese eshte paraqitur dokumenti doganor per regjim te perkohshme pasi ne nuk mendojme se eshte paraqitur nje dokument i tille. Gjithashtu regjimi i perkohshem doganor ka nje afat maksimal prej 1 viti dhe nuk mund te jete me shume se 1 vit, ndaj kerkojme verifikimin e kesaj kontrate qeraje nese ka paraqitur te tille dhe nese e ka paraqitur ne kontrate me afat me shume se nje vit eshte nje kontrate me vese dhe si e tille eshte e pavlefshme. Sa me siper kerkojme verifikimin e te gjithe dokumentacionit per makinerine 50x70 nese eshte marre me qira dhe te gjithe dokumentacionin e saj si me siper ne rastin kur eshte marre me qera pasi kemi dyshime se nuk plotesojne kerkesat e autoritetit kontraktor per kualifikim. Te verifikohet dokumenti doganor pasi dyshojme se nuk eshte paraqitur ne SPE asnje dokument i tille, ne rast se makina ka kaluar kufirin shqiptar pra nese eshte futur ne kete shtet. Ne legjislacionin ne fuqi eshte percaktuar qe: Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet per materialet profesionale.

2. Pajisje profesionale do të thotë: a) pajisje per shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, që i nevojiten përfaqësuesve të shtypit ose të transmetimeve radiofonike apo televizive të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që vizitojnë Shqiperine per qëllime reportazhi ose per të transmetuar apo regjistruar materiale per programe të caktuara; b) pajisje kinematografike që i nevojitet një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që viziton Shqipërinë për të xhiruar një ose disa Filma të caktuar; c) cdo pajisje tjetër të nevojshem per ushtrimin e zanatit, tregtisë ose profesionit nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që viziton Shqiperine per të kryer një detyrë të caktuar. Nuk perfshin megjithatë, kjo kategori, pajisjet të cilat do të perdoren per prodhimin industrial ose paketimin e mallrave ose (me perjashtim të veglave të dores) per shfrytëzimin e rezervave natyrore, per ndertimin, riparimin ose mirembajtjen e ndërtesave, për gjermimin dhe zhvendosjen e dherave si dhe pune të tjera të ngjashme; d) aparatura ndihmese per pajisjet e permendura ne nenparagrafet (a), (b) dhe (c) me siper dhe aksesoret perkatës. Lista e mallrave që quhen materiale profesionale pasqyrohet ne Aneksin 42. 3. Regjimi i lejimit të perkohshem permendur ne paragrafin 1, jepet me kusht që pajisjet profesionale : a) t'i perkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë; b) të importohen nga një person i vendosur jashtë këtij territori; c) të perdoren vetëm ose nen mbikyrjen personale të personit që viziton këtë territor. [...]”.

Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar nga AK: 2.3.5 Operatori ekonomik per materialet shtypshkrime duhet të disponojë: Makineri shtypi offset me minimalisht 2 (dy) ngjyra dhe format minimal 50 x 70 cm; Makineri palosje format 50 x 70; Makineri per numerator; Makineri per mbledhjen automatike te letres kimike; Binder per ngjitjen e kopertinave; Makinë qepëse me tel; Pajisje CTP per parapergatitje per shtyp.

Operatori ekonomik per të vertetuar disponimin e pajisjeve te mesiperme duhet te paraqese dokumentacionin ne nje nga format e meposhtme: Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose Kontrate huaperdorje, ose Kontrate qiramarrje, ose kontrata e dhurimit, ose ne rast se posedon makinerine/te me qira ose huaperdorje, duhet te paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur para noterit me afat kohezgjatje minimalisht sa kohezgjatja e afatit te kontrates objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor ne cdo rast i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive pranë ambienteve të ofertuesit.

Ne keto kushte, nese eshte paraqitur nje kontrate e tille noteriale qeraje atehere duhet te verifikohet i gjithe dokumenti si me siper analizuar nga ana e autoritetit kontraktor pasi ne mendojme se nuk ploteson krieret e parqitura (te verifikohen deklaratat dogane a eshte per produktet per te cilat eshte lidhur kontrata, duhet verifikuar regjimi doganor se eshte 1 vit nderkohe qe duhet verifikuar sa e ka vendosur AK kujt regjimi doganor i perket. Nese eshte paraqitur dokument per makinerite me qera kerkojme verifikimin e tij pasi kemi dyshime se nuk eshte paraqitur per te anje dokument doganor per regjim te perkohshem. Dyshojme se shoqeria nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem per disponibilitetin e makinerive Binder dhe Makineri per Numerator. Gjithashtu mendojme se dokumentacioni per makinerine e palosjes ne dokumentacionin e dorezuar ne SPE nuk ka te shenuar formatin e saj nje element ky i rendesishem dhe qe perben shkak per skualifikimi nga procedura e prokurimit. Nese ky dokument nuk permban formatin e makinerise atehere ai nuk duhet te konsiderohet i vlefshem dhe operatori duhet te skualifikohet, qendrim i mbajtur ky edhe nga KPP ne vendime te ndryshme te tij ne lidhje me kete pike ne raste te ngjashme. Lidhur nga eksperiencia qe kemi ne kete fushë dhe duke ditur si operon tregu dhe bashkepunimet e ndryshme, dyshojme se eshte paraqitur dokumentacion se shume mjete kane nje akt dhurimi i cili eshte bere me akt noterial per te cilin kerkojme te verifikohen te gjithe elementet e tij, qe ne baze te ligjit per noterine nuk do te jete i vlefshem nuk ka te dhenat elementare e te rendesishme sic jane edhe origjina e mallrave, duke treguar keshtu sipas legjislacionit ne fuqi, si edhe duke verifikuar keto, pra nese nuk eshte

deklaruar origjina e makinerive ky akt i dhenies me qera do te jete i pavlefshem. Edhe ne lidhje me Kontratat e ngjashme te paraqitura kemi dyshime qe nuk jane shoqeruar bashke me faturat tatimore per katese sipas kerkeses se Ak me ane te kriterit te vendosur. Gjithashtu edhe i gjithe dokumentacioni qe e shoqeron si vleresim etj kerkojme te behet ne dite tjere si dhe te verifikohet nese ai eshte ne perputhje me te gjithe elementet e percaktuar nga legjislacioni ne fuqi. Kerkojme te verifikohet i gjithe dokumentacioni i paraqitur per mjete pasi dyshojme se kane probleme legalizimi, tejkallim te afatit te regjistrimit doganor, deklarimi i origjines se makinerive, vlersimi i makinerise si eshte bere me ke eshte bere, me inxhinier apo vleresues te licencuar apo jo per vleresim makines pra ekspert ne kete fushe dhe jo fushe tjeter, dhe deri ne sa vjet jete i kane dhene. Sa me siper kerkojme skualifikimin e ketij operatori si operatori qe nuk ploteson kriteret per kualifikim. [...]"

II.7.Në datën 30.12.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.25755/1prot. datë 27.12.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesve,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankimues “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsytet përkatëse:

[...]OE Kristalina KH nuk paraqet Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise dhe Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne perputhje me objektin e prokurimit. Certificate ISO kane per objekt vetem shtypshkrimet dhe jo kancelarite [...]",
[...]OE Albdesign PSP nuk paraqet Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise dhe Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne perputhje me objektin e prokurimit. Certificate ISO kane per objekt vetem shtypshkrimet dhe jo kancelarite [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 9, pika 3.2.3 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Certificate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise, te vlefshme e leshuar nga nje organ i akredituar.

Certificate ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, te vlefshme e leshuar nga nje organ i akredituar.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve, secili anetar duhet te paraqese ISO ne perputhje me zerat qe do te marre persiper te furnizoje”

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se operatorët ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

“Kristalina - KH” sh.p.k.

- Certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, lëshuar nga trupa certifikuese CertiW, në gjuhë të huaj, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
- Certifikatë ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit, lëshuar nga trupa certifikuese CertiW, në gjuhë të huaj, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

“Albdesign PSP” sh.p.k.

- Certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, lëshuar nga trupa certifikuese CertiW, në gjuhë të huaj, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
- Certifikatë ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit, lëshuar nga trupa certifikuese CertiW, në gjuhë të huaj, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

1.Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.5. Lidhur me pretendimet e ankimesve “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., mbi objektin e veprimtarisë të certifikatave të cilësisë, të paraqitura nga ana e tyre, Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik kryejnë aktivitetin objekt

prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatorët ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., për të vërtetuar se kryejnë aktivitetin e tyre sipas standarteve, kanë paraqitur certifikatat e mësipërme, lëshuar nga organizimi certifikues CertiW.

III.1.6.Nga shqyrtimi i këtyre certifikatave, rezulton se operatori ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. është certifikuar për aktivitetet *“Sigurimi i veprimtarive të topografisë dhe printimit të materialeve të reklamimit, botimit si dhe materialeve të tjera”*. Ndërsa operatori ekonomik ankimes “Albdesign PSP” sh.p.k. është certifikuar për aktivitetet *“Dizenjim dhe prodhim të gjitha produkteve shtypshkrime, botimeve, shtypshkrimeve me element sigurie, materialeve promocionale, materialeve të paketimit, etiketa, printim fatura dhe zarfim, material reklamuese, prodhimin dhe montimin e paneleve reklamuese si dhe tregtim i materialeve prej kompoziti dhe kapake dhe zgara gize”*. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatorët ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk arrijnë të vërtetojnë se kryejnë aktivitetin për tregëtim/prodhim të artikujve standart kancelarik (artikuj zyre) sipas standarteve të kërkuara, pasi me anë të certifikatave të sipërcituara, ankimesit vërtetojnë se janë të certifikuar sipas standarteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për shërbimet/punët/mallrat e sipërcituara, të cilat referuar kodeve EA sipas dokumentit udhëzues të Organizmit European të Akreditimit, që bazohen në aneksin 1, të rishikimit 2, të *“NACE- National Classifications of Economic Activities”* (Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve Ekonomike), miratuar në Rregulloren (EC) të Parlamentit European nr.1893/2006, janë kategori të ndryshme me aktivitetin për tregëtim/prodhim të artikujve standart kancelarik (artikuj zyre), si dhe me kode EA të vecanta. Referuar në udhëzimet dhe manualët e organizmave të akreditimit si EA dhe IAF, Komisioni gjykon se në certifikatën e lëshuar për subjektin duhet specifikuar domosdoshmërisht aktiviteti konkret për të cilin subjekti përmbush standartin, pasi për certifikimin e një subjekti në një apo më shumë standarte, organizmat certifikuese janë të detyruara të kryejnë auditimet përkatese të cilat janë specifike sipas fushës së veprimtarisë. Vlen të theksohet, se operatorët ekonomikë duhet të jenë të certifikuar mbi standartet e cilësisë për të gjitha fushat e veprimtarisë objekt prokurimi, pasi certifikimi në fusha veprimtarie të tjera e bën vendosjen e kriterit të vecantë të kualifikimit dhe paraqitjen e këtyre certifikatave të pakuptimtë.

III.1.7.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorëve ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorëve ekonomik ankimues “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatorët ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., nuk përmbushi kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palëve ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtyre operatorëve ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorëve ekonomik ankimues “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistics” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se : Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.1. Normativa e mësipërme rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP. Procedura përpara KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (lat.- jurisdicion voluntari) pasi KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga kërkesat apo ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar. Formula ligjore e parashikuar nga Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) përcakton në mënyrë definitive elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin. Në kuptim të nenit 63, pika 7, Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik.

III.3.2. Një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

III.3.3. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm (e jo thjesht në mënyrë imagjinare) të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar apo skualifikohet gjatë hetimit administrativ të KPP, nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte

fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorëve ekonomik ankimes “Kristalina - KH” sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k., lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistics” sh.p.k. nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *“OE InfoSoft Office nuk ploteson kriterin e pervojave (furnizimeve) te meparshme, te ngjashme per zerat shtypshkrime”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikën 2.3.1 të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 50,000,000 (Pesdhjete milion) leke

Ne rast se kontrata është kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Ne rast se kontrata është kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara”

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.3. Në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: - Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. - Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. - Në rastin e përvojës së*

mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.4. Nga verifikimet e kryera në SPE, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, ka paraqitur një numër të konsiderueshëm dokumentacioni me anë të të cilit vërteton se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit me disa autoritete kontraktore dhe subjekte private për artikujt standart kancelarik (artikuj zyre), si dhe disa furnizime me produkte me logo të personalizuar, me vlerë modeste krahasuar me vlerën e kontratës objekt prokurimi. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet si i ngjashëm me objektin e prokurimit, përse i përket artikujve objekt prokurimi të cilat realizohen me anë të shtypshkrimit, pasi për realizimin e një pjese të madhe të zërave të artikujve objekt prokurimi, sic janë libreza e energjisë me hologramë, proces-verbalët me numër serie etj., referuar specifikimeve teknike, kërkojnë ekspertizë të thelluar dhe të posacme në aktivitetin e shtypshkrimit. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës se ajo është një kontratë mallrash dhe ky fakt mjafton, por duhet parë në lidhje me zërat konkretë të mallrave të furnizuara, si dhe karakteristikat e tyre. Në rastin konkret, në faturat dhe kontratat e paraqitura nuk ka asnjë zë që vërteton se operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., gëzon eksperiencën e nevojshme për të realizuar kontratën objekt prokurimi, përse i përket furnizimit me artikuj të cilët realizohen domosdoshmërisht me anë të teknikave të posacme të shtypshkrimit.

III.4.5.Referuar legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar . Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojnë se ka kryer furnizime të ngjashme të një pjese të konsiderueshme të artikujve objekt prokurimi, e për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. nuk qëndron.

III.5.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi e mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbushi kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk

ndryshon gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a*”, me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k., për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1895 protokoli Datë 18.12.2019; Nr. 1898 protokoli Datë 18.12.2019;

Nr. 1900 protokoli Datë 19.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha